

AKT THEMELIMI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“KOI WRAP” SH.P.K.

(1) Sot, më date **08.09.2021**, ne themeluesit, kemi krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin **“KOI WRAP” SH.P.K.**

(2) Themeluesit e shoqërisë janë:

- **Piro Andon Vasili (dt.22.12.1988,Tirane)**

- **Erion Fatos Lumi (dt.12.09.1988,Tirane)**

Neni 1

Shoqëria krijohet dhe ushtron veprimtarinë e saj ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi dhe sidomos Ligjit Nr. 9901, dt. 14.04.2008 “Per Tregtaret dhe Shoqëritë tregtare”; aktet e tjera ligjore qe do te jene ne fuqi gjate veprimtarise se Shoqërise, si dhe me dispozitat e Statutit te Shoqërise qe i bashkangjitet ketij Akti Themelues.

Neni 2

Emertimi i shoqërise eshte **“KOI WRAP” SH.P.K.**

Neni 3

Selia e shoqërise ndodhet ne : **“Rruga Abdyl Frasheri nr pasurie 262/4 zona kadastrale 3866, Yzberisht,Tirane”** Trasferimi i selise se Shoqërise ne nje adrese tjetër behet me miratimin e Asamblese se ortakeve te shoqërise.

Neni 4

Objekti i veprimtarise se Shoqërise do te jete: **“Veshje makina me adeziv. Sherbime lucidimi dhe sherbime te ndryshme. Import-eksport, tregeti me shumice e pakice te mallrave te ndryshem, transport mallrash brenda dhe jashte vendit, ushqimore, kepuce, veshmbathje, tekstile, artikuj lekure, industrial, detergjente, kozmetike, hidrosanitare e kondicionomi, material ndertimi, hapje punishte per perpunim, prodhim, tregetim lendesh te para dhe mallrash, hapje agjensi imobilare, te shese te jap me qera pasuri te tundshme dhe te patundshme, hapje servis makinash dhe shitblerje pjese kembimi per auto, goma automjetesh te ndryshme, hapje agjensi turistike.”**

Neni 5

Kohezgjatja e Shoqërise eshte percaktuar per nje periudhe te pakufizuar kohe, por sidoqofte jo me pak se **20 vjet**, duke filluar nga data e regjistrimit te saj ne Qendren Kombetare te Biznesit.

Neni 6

(1) Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është **100.000 Lekë**. Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

1. Ortaket themelues **Piro Vasili** : Zoterues i **1 (një)** kuote me vlerë të përgjithshme që përben **50 %** të kapitalit themeltar të shoqërisë.

2. Ortaket themelues **Erion Lumi** : Zoterues i **1 (një)** kuote me vlerë të përgjithshme që përben **50 %** të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë.

Ortaket kane te drejte te beje zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit sipas vendimit qe merr Asambleja e Ortakeve.

Neni 7

Ne marredheniet me te tretet, shoqeria tregetare **“KOI WRAP” SH.P.K.** perfaqesohet nga Admnistratori i Shoqerise.

Neni 8

Cdo gje qe do te kryhet parashikohet ne statutin e shoqerise, kopje e te cilit do te depozitohet ne Qendren Kombetare te Biznesit.

Neni 9


Ky Akt Themelimi eshte hartuar ne Tirane, me 08.09.2021 ne kater ekzemplare origjinale ne gjuhen shqipe, duke patur te gjithe fuqi te barabarte ligjore.

ORTAKET

E SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

“KOI WRAP” SH.P.K

Piro Vasili



Erion Lumi

